



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1784 /₄ Prot

Tiranë, më 07 /12 /2021

VENDIM

Nr. 54 , datë 07 .12 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesat nr. 1784 Prot., datë 27.10.2021 (vijuar me nr. 1784/3 Prot., datë 09.11.2021) dhe nr. 1885 Prot., datë 15.11.2021 (vijuar me nr. 1885/3 Prot., datë 25.11.2021), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Duke qenë se, ankesat lidhen me të njëjtin dokument dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesi, në cilësinë e gazetarit pranë Qendrës “Birn Albania”, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 13.10.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- Cila është kompania/sipërmarrja private që ka kryer mbështetje financiare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “KPK”), për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të aktivitetit me temë “Raport & Strategji”, të zhvilluar më datë 30 shtator 2021, në ambientet e hotel “Marina Bay”, Vlorë, që sipas

informacionit të servirur nga vetë KPK në kthimin e përgjigjes së datës 13.10.2021 është në shumën 300 mijë lekë.

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës datë 26.10.2021, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- *Kopje e kontratës së nënshkruar me kompaninë/sipërmarrjen private që ka kryer mbështetje financiare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim KPK), për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të aktivitetit me temë "Raport & Strategji", të zhvilluar më datë 30 shtator 2021, në ambientet e hotel "Marina Bay", Vlorë që sipas informacionit të servirur nga vetë KPK në kthimin e përgjigjes së datës 13.10.2021 është në shumën 300 mijë lekë.*

Lidhur me kërkesën datë 13.10.2021, Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 7021/1 Prot., datë 25.10.2021, ka kthyer përgjigje duke cituar se: "...bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", e konsiderojmë përgjigjen e dhënë nga Komisioni me nr.6833/1 Prot, datë 13.10.2021, në përputhje me të drejtën tuaj për t'u informuar. Një pjesë e informacioneve të diskutuara në aktivitet janë konfidenciale, po ashtu organizimi dhe zhvillimi i këtij aktiviteti përmban klauzola kontraktuale, që e kufizojnë aksesin e palëve të treta jashtë këtij aktiviteti".

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, pretendon se: "...Autoriteti Publik, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka refuzuar të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar me pretendimin se zhvillimi i këtij aktiviteti përmban klauzola kontraktuale, që e kufizojnë aksesin e palëve të treta jashtë këtij aktiviteti". Në vijim, kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Për sa i përket kërkesës datë 26.10.2021, ankuesi pretendon se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Autoriteti Publik.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ato përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Komisioneri, me shkresat nr. 1784/1 prot., datë 29.10.2021 dhe

nr.1885/1 Prot., datë 17.11.2021, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me ankesat e paraqitura.

Në vijim, Autoriteti Publik me shkresën nr. 7426/1 Prot., datë 05.11.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1784/2 Prot., datë 05.11.2021, ka informuar ndër të tjera se: *“...1. Marrëveshja tri-palëshe ndërmjet kompanisë financuese dhe ofruesit të shërbimit që ka kryer organizimin për llogari të eventit të KPK-së, parashikon klauzola kufizuese dhe përjashtuese për palët e treta jashtë kësaj marrëveshje sponsorizimi.*

2. Duke qenë se marrëveshja ka natyrë konfidenciale, si dhe duke mbajtur parasysh nenin 17 të ligjit nr. 119/2014, Komisioni ka vlerësuar objektivisht dhe proporcionalisht që nga njëra anë kërkuesi të informohet dhe nga ana tjetër të mos cënohet e drejta private e palëve në këtë marrëveshje sponsorizimi, duke mos i vënë në dispozicion detaje për palën financuese.

3. Komisioni i ka konsideruar shteruese dy përgjigjet që i ka kthyer subjektit Birn Albania, duke e informuar atë mbi: temën e aktivitetit, kohëzgjatjen e tij, vendin ku është organizuar, numrin e pjesëmarrësve, akomodimin e komisionerëve dhe stafit ndihmës, si dhe koston totale të shpënzimeve të kryera dhe të mbuluara nga marrëveshja tri-palëshe për këtë aktivitet...”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 1784/3 Prot., datë 09.11.2021, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik për të vënë në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës.

Lidhur me ankesën nr. 1885 Prot., datë 15.11.2021, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7758/1 Prot., datë 23.11.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1885/2 Prot., datë 24.11.2021 duke sqaruar se: *“...Referuar parashikimit ligjor të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në frymën e bashkëpunimit me median Birn Albania, institucioni vë në dispozicion kopje të anonimizuar të marrëveshjes tri-palëshe ndërmjet kompanisë financuese dhe ofruesit të shërbimit që ka kryer organizimin për llogari të eventit të KPK-së. Vlerësojmë së në këtë mënyrë, respektohen proporcionalisht klauzolat kufizuese dhe përjashtuese për palët e treta jashtë kësaj marrëveshjeje, sikurse dhe e drejta për informim”.*

Në vijim, ankuesi pretendon se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik me anë të kësaj shkrese, është në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në këto kushte ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 1885/3 Prot., datë 25.11.2021.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesave/ankesave ka të bëjë me një marrëveshje sponsorizimi, për të cilën Autoriteti Publik, pretendon se nuk mund ta vendosë në dispozicion për shkak të parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuar në këtë marrëveshje.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuftim të këtij parashikimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështetet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar apo kufizimin e pjesëve të anonimizuara të kësaj marrëveshje. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzoleve kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuar në këtë marrëveshje, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Në këto kushte, vlerësohet se Autoriteti Publik, në kundërshtim me LDI, ka anonimizuar edhe të dhënat e shoqërive tregtare të cilat nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe përpunimi i të dhënave të tyre nuk kufizohet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Në këto kushte, nga Autoriteti Publik duhet të rivlerësohet dokumentacioni dhe vetëm nëse marrëveshja përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave të cilët nuk janë përfaqësues të shoqërive tregtare, përhapja e të dhënave mund të çënojë privatësinë e tyre, në këtë rast këto të dhëna duhet të anonimizohen.

Për sa i përket kërkesës datë 13.10.2021, konstatohet se ky informacion përfshihet në marrëveshjen e kërkuar në kërkesën për informacion datë 26.10.2021 dhe bazuar në sa më sipër arsyetuar, përbën informacion publik pasi nuk provohet të ketë shkak ligjor për kufizimin e tij.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në kërkesat për informacion datë 13.10.2021 dhe 26.10.2021 përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe kufizimet e pasqyruara në marrëveshje nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuar në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave nr. 1784 Prot., datë 27.10.2021 dhe nr. 1885 Prot., datë 15.11.2021 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesave për informacion datë 13.10.2021 dhe 26.10.2021, në lidhje me:
-Kopje e kontratës së nënshkruar me kompaninë/sipërmarrjen private që ka kryer mbështetje financiare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim KPK), për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të aktivitetit me temë “Raport & Strategji”, të zhvilluar më datë 30 shtator 2021, në ambientet e hotel “Marina Bay”, Vlorë që sipas informacionit të servitur nga vetë KPK në kthimin e përgjigjes së datës 13.10.2021 është në shumën 300 mijë lekë, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 15.12.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 07.12.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

